

**3P Life Logistic sh.p.k.**

**Raporti i Audituesit të Pavarur dhe  
Pasqyrat Financiare më dhe për  
vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015**



## RAPORTI I AUDITUESIT TË PAVARUR

Drejtimin dhe Aksionarëve të 3P Life Logistic sh.p.k:

### **Raport mbi pasqyrat financiare**

Ne kemi audituar pasqyrat financiare të 3P Life Logistic sh.p.k. bashkëngjitur, të cilat përfshijnë pasqyrën e pozicionit financiar më 31 dhjetor 2015 dhe pasqyrën e fitimit ose humbjes dhe të ardhurave të tjera përmbledhëse, pasqyrën e ndryshimeve në kapital dhe pasqyrën e rrjedhës së parasë për vitin e mbyllur në këtë datë, si dhe një përmbledhje të politikave bazë kontabël dhe shënime të tjera shpjeguese.

### **Përgjegjësia e Drejtimit për Pasqyrat Financiare**

Drejtimi është përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të këtyre pasqyrave financiare në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar, dhe për kontrollin e brendshëm i cili, në masën që përcaktohet nga Drejtimi, është i nevojshëm për të bërë të mundur përgatitjen e pasqyrave financiare pa pasaktësi materiale, si pasojë e mashtrimeve apo gabimeve.

### **Përgjegjësia e Audituesit**

Përgjegjësia jonë është që, bazuar në auditimin tonë, të shprehim një opinion mbi këto pasqyra financiare. Ne e kryem auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit. Këto standarde kërkojnë që ne të përmbushim kërkesat e etikës dhe të planifikojmë dhe të kryejmë auditimin, me qëllim që të përfitojmë siguri të arsyeshme që pasqyrat financiare nuk kanë pasaktësi materiale.

Auditimi përfshin kryerjen e procedurave për sigurimin e të dhënave të auditimit për vlerat dhe deklaratimet në pasqyrat financiare. Procedurat e përzgjedhura varen nga gjykimi i audituesit, përfshirë këtu dhe vlerësimin e rreziqeve të ekzistencës së pasaktësive materiale në pasqyrat financiare, qoftë si rezultat i mashtrimeve apo i gabimeve. Gjatë vlerësimit të rreziqeve, audituesi merr në konsideratë kontrollin e brendshëm në lidhje me përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiare në mënyrë që të projektojë procedurat e auditimit të cilat janë të përshtatshme në rrethanat e caktuara, por jo për qëllimin e shprehjes së një opinion mbi efektivitetin e kontrollit të brendshëm të entitetit. Një auditim përfshin gjithashtu vlerësimin për përshtatshmërinë e politikave kontabël të përdorura dhe arsyeshmërinë e vlerësimeve kryesore të bëra nga Drejtimi, si dhe vlerësimin e paraqitjes së përgjithshme të pasqyrave financiare.

Ne besojmë se të dhënat e auditimit që kemi marrë ofrojnë baza të mjaftueshme dhe të përshtatshme për dhënien e opinionit tonë të auditimit.

### **Opinion**

Sipas opinionit tonë, pasqyrat financiare paraqesin në mënyrë të drejtë, në të gjitha aspektet materiale, pozicionin financiar të 3P Life Logistic sh.p.k. më 31 dhjetor 2015 si dhe performancën financiare dhe rrjedhën e parasë për vitin e mbyllur në këtë datë, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar.

### **Çështje të tjera**

Pasqyrat financiare të 3P Life Logistic sh.p.k. për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2014 nuk janë audituar.

*Deloitte Audit Albania sh.p.k.*  
3 nëntor 2016  
Tiranë, Shqipëri

*Nuriona Sokoli Bërdica*  
Partner Angazhimi

**DELOITTE AUDIT ALBANIA**

3P Life Logistic sh.p.k.  
Pasqyra e pozicionit financiar më 31 dhjetor 2015

(Shumat janë të shprehura në LEK)

	Shënime	Më 31 dhjetor 2015	Më 31 dhjetor 2014 (të pa audituara)
<b>Aktivet</b>			
<b>Aktive afatgjata</b>			
Aktive afatgjata materiale	4	164,180,067	-
Aktive afatgjata jomateriale – Kontrata e Konçesionit	5	284,376,062	-
<b>Totali i aktiveve afatgjata</b>		<b>448,556,129</b>	-
<b>Aktive afatshkurta</b>			
Mjete monetare dhe ekuivalentet e tyre	6	12,636,819	30,000,000
Inventarët		20,389,999	-
Llogari të arkëtueshme dhe aktive të tjera	7	114,937,042	-
Parapagim Tatim Fitimi		1,317,644	-
<b>Totali i aktiveve afatshkurta</b>		<b>149,308,864</b>	<b>30,000,000</b>
<b>TOTALI I AKTIVEVE</b>		<b>597,864,813</b>	<b>30,000,000</b>
<b>Kapitali aksionar</b>			
Kapitali aksionar			
Fitimi i vitit	8	30,000,000	30,000,000
<b>Totali i kapitalit aksionar</b>		<b>45,970,005</b>	-
<b>Kapitali aksionar</b>		<b>75,970,005</b>	<b>30,000,000</b>
<b>Detyrime afatshkurta</b>			
Llogaritë e pagueshme	9	379,312,194	-
Detyrime të tjera	10	5,892,155	-
Grant nga Pegasus	11	32,574,703	-
<b>Totali i detyrimeve afatshkurta</b>		<b>417,779,052</b>	-
<b>Detyrime afatgjata</b>			
Vlera e riinvestimit	12	104,115,756	-
<b>Totali i detyrimeve afatgjata</b>		<b>104,115,756</b>	-
<b>Totali i kapitalit aksionar dhe detyrimeve</b>		<b>597,864,813</b>	<b>30,000,000</b>

Pasqyra e pozicionit financiar duhet të lexohet së bashku me shënimet shpjeguese në faqet 6 – 22 që janë pjesë përbërëse e pasqyrave financiare.

Këto pasqyra financiare janë miratuar nga Drejtimi i Shoqërisë më 1 nëntor 2016 dhe firmosur nga:

Z. Altin Fani  
Drejtor Menaxhimi

Zj. Manjola Seferi  
Drejtor Financie

**3P Life Logistic sh.p.k.**

**Pasqyra e fitimit ose humbjes dhe të ardhurave të tjera më 31 dhjetor 2015**

*(Shumat janë të shprehura në LEK)*

	Shënime	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2014 (të pa audituara)
<b>Të ardhurat</b>			
Të ardhura	13	554,036,242	-
Të ardhura të tjera	14	20,983,888	-
<b>Totali i të ardhurave</b>		<b>575,020,130</b>	-
<b>Shpenzimet</b>			
Shpenzime për kontratën e konçesionit	15	(242,232,567)	-
Shpenzime personeli	16	(54,591,195)	-
Zhvlerësimi dhe amortizimi	4,5	(25,742,697)	-
Shpenzime operative dhe të tjera	17	(205,511,069)	-
<b>Totali i shpenzimeve</b>		<b>(518,894,084)</b>	-
<b>Fitimi nga veprimtaritë e shfrytëzimit</b>		<b>56,126,046</b>	-
<b>Të ardhurat financiare</b>			
Fitim nga kursi i këmbimit	18	17,687	-
<b>Totali i shpenzimeve financiare</b>		<b>17,687</b>	-
<b>Fitimi para tatimit</b>		<b>56,143,733</b>	-
Shpenzimet e tatim fitimit	19	(10,173,728)	-
<b>Fitimi neto</b>		<b>45,970,005</b>	-
Të ardhura të tjera gjithpërfshirëse		-	-
<b>Totali i të ardhurave të tjera gjithpërfshirëse</b>		<b>45,970,005</b>	-

Pasqyra e fitimit ose humbjes dhe të ardhurave të tjera gjithpërfshirëse duhet të lexohet së bashku me shënimet shpjeguese në faqet 6-22 që janë pjesë përbërëse e pasqyrave financiare

**3P Life Logistic sh.p.k.****Pasqyra e fitimit ose humbjes dhe të ardhurave të tjera më 31 dhjetor 2015***(Shumat janë të shprehura në LEK)*

	<b>Kapitali aksionar</b>	<b>(Humbjet e mbartura) / Fitimi i pashpërndarë</b>	<b>Totali</b>
Kontributi ne kapital	30,000,000	-	30,000,000
<b>Më 31 dhjetor 2014 (të pa audituara)</b>	<b>30,000,000</b>	<b>-</b>	<b>30,000,000</b>
Fitimi i vitit	-	45,970,005	45,970,005
Të ardhura të tjera gjithpërfshirëse	-	-	-
<b>Më 31 dhjetor 2015</b>	<b>30,000,000</b>	<b>45,970,005</b>	<b>75,970,005</b>

Pasqyra e ndryshimeve në kapital duhet të lexohet së bashku me shënimet shpjeguese në faqet 6-22 që janë pjesë përbërëse e pasqyrave financiare.

Shënime	Për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2015	Për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2014 (të pa audituara)
<b>Rrjedha e mjeteve monetare nga aktivitetet operative:</b>		
Fitimi para tatimit	56,143,733	-
<i>Rregullime për:</i>		
Zhvlerësimi dhe amortizimi	25,742,698	-
Tatim fitimi	(10,173,728)	-
<b>Fitimi nga aktiviteti para ndryshimeve në kapitalin punues</b>	<b>71,712,702</b>	-
Rritje në inventar	(20,389,999)	-
Rritje në llogaritë e arkëtueshme	(114,937,042)	-
Rritje në llogaritë e pagueshme	379,312,194	-
Rritje në detyrime të tjera	5,892,155	-
Tatimi fitimi i paguar	(1,344,824)	-
<b>Fluksi monetar neto i gjeneruar nga aktivitetet operative</b>	<b>320,245,186</b>	-
<b>Rrjedha e parasë nga aktivitetet investuese:</b>		
Blerja e aktiveve afatgjata materiale	(146,936,485)	-
Blerja e aktiveve afatgjata jomateriale	(190,671,882)	-
<b>Paraja neto e përdorur në aktivitetet investuese</b>	<b>(337,608,367)</b>	-
<b>Rrjedha e parasë nga aktivitetet e financimit</b>		
Kapitali i paguar	-	30,000,000
<b>Paraja neto e përdorur në aktivitetet financuese</b>	-	<b>30,000,000</b>
<b>Rritja neto e mjeteve monetare dhe ekuivalentëve të tyre</b>	<b>(17,363,181)</b>	-
Mjetet monetare dhe ekuivalentet e tyre në fillim të vitit	30,000,000	-
<b>Mjetet monetare dhe ekuivalentet e tyre në fund të vitit</b>	<b>12,636,819</b>	<b>30,000,000</b>

6

Pasqyra e rrjedhës së parasë duhet të lexohet së bashku me shënimet shpjeguese në faqet 6-22 që janë pjesë përbërëse e pasqyrave financiare.

## **1. HYRJE**

3P Life Logistic sh.p.k. (Shoqëria) është një Shoqëri me Përgjegjësi të Kufizuar, e vendosur në Republikën e Shqipërisë dhe e regjistruar më 9 dhjetor 2014 në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit. Adresa e zyrave qendrore është në Autostradën Tiranë – Durrës, km 9.

Struktura e kapitalit të Kompanisë përbëhet nga 80% të totalit të kapitalit të nënshkruar të aksioneve nga Marketing & Shpërndarjes Sh.p.k. dhe 20% nga Trimed Sh.p.k.

Aktiviteti kryesor i biznesit të Kompanisë përfshin paketën e shërbimit të kontrollit mjekësor për moshat 40-65 vjeç, për një periudhë prej 10 vjetësh, siç parashikohet në marrëveshjen e koncesionit nënshkruar ndërmjet 3P Life Logistic sh.p.k. dhe Ministrisë së Shëndetësisë, më 7 janar 2015.

Më 31 dhjetor 2015, Kompania ka të punësuar 123 punonjës.

### ***Marrëveshja e koncesionit***

#### ***Përshkrim i marrëveshjes***

Bazuar në marrëveshjen e koncesionit të firmosur mes 3P Life Logistic sh.p.k. dhe Ministrisë së Shëndetësisë më 7 janar 2015, Ministria e Shëndetësisë autorizon Kompaninë të planifikojë, financojë dhe zbatojë paketën e shërbimit të kontrollit mjekësor për moshat 40-65 vjeç sic detajohet më poshtë:

#### **a) Paketa bazë e kontrollit mjekësor**

Kompania do të sigurojë pajisjet, mjetet dhe materialet mjekësore ose jo mjekësore për të siguruar shërbime logjistike dhe për të zbatuar paketën e Kontrollit Bazë Mjekësor.

Kompania merr përsipër të furnizojë Qendrat Shëndetësore me mjetet dhe materialet e nevojshme për kontrollin bazë, transportimin e kampioneve nga Qendrat Shëndetësore në Laboratorët e Koncesionarit, ekzaminimin e tyre dhe hedhjen e rezultateve në Sistem.

#### **b) Serveri i aplikimeve:**

- Dixhitalizimi i të dhënave mjekësore;
- Hyrja dhe ruajtja e të dhënave në faqen qendrore të personalizuar dhe ndertimin e mbeshtetjes (backup);

#### **c) Baza e të dhënave:**

- Ruajtja e të dhënave dhe përdorimi i tyre;
- Trajtimi dhe përpunimi i të dhënave;

#### **d) Software i ndërtimit të indikatorëve të monitorimit dhe vlerësimit të rezultateve të kontrollit mjekësor bazë:**

- Oracle business intelligence

#### **e) Sistemi i auditimit:**

- Mbrojtja e të dhënave konfidenciale
- Automatizimi i të dhënave të auditit
- Menaxhimi i centralizuar i regjistrimit të të dhënave.

#### ***Periudha e koncesionit:***

Koncesioni është dhënë për një periudhë 10 vjeçare, duke filluar më 31 mars 2015.

Në fund të kontratës Kompania do të kthejë Ministrisë së Shëndetësisë të gjitha pajisjet, materialet mjekësore dhe jo-mjekësore dhe pajisjet e qendrave shëndetësore të kontratës së koncesionit.

Të gjitha strukturat e tjera, që nuk janë mundësuar nga Ministria e Shëndetësisë por Kompania i ka ndërtuar për të përmirësuar shërbimin, do të jenë në pronësi të Kompanisë.

#### **Mekanizmi i pagesës**

Çmimi pa TVSH do të jetë 1,537 Lek për person dhe vlera minimale vjetore e pagueshme nga Ministria e Shëndetësisë për Kompaninë është 730,075,000 Lek pa TVSH për çdo vit.

Nëse numri i personave tejkalon 475,000, Ministria e Shëndetësisë duhet t'i paguajë Kompanisë diferencën prej 1,537 Lek për çdo kontroll mjekësor të bërë më shumë.

## 1. HYRJE (VAZHDIM)

### *Marrëveshja e koncesionit (vazhdim)*

#### *Riinvestimet e Kompanisë*

Kompania ka detyrim të mirëmbajë pronën sipas kontratës së Koncesionit. Kompania do të investojë në 4 vitet e fundit të termave të kontratës një shumë prej 129,999,890 Lek.

## 2. BAZA E PËRGATITJES

### 2.1 Deklarata e pajtueshmërisë

Pasqyrat financiare janë përgatitur në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF). Pasqyrat financiare janë përgatitur duke përdorur bazën e përlllogaritjes të specifikuar nga SNRF për secilin lloj të aktiveve, detyrimeve, të ardhurave dhe shpenzimeve. Bazat e matjes janë përshkruar më gjerësisht në politikat kontabël më poshtë.

### 2.2 Bazat e matjes

Pasqyrat financiare janë përgatitur mbi bazën e kostos historike. Këto pasqyra financiare janë përgatitur dhe prezantuar në monedhën Shqiptare Lek.

### 2.3 Përdorimi i vlerësimeve dhe gjykimeve

Përgatitja e pasqyrave financiare në përputhje me SNRF kërkon nga drejtuesit të ushtrjnë gjykimin e tyre në procesin e zbatimit të politikave kontabël të Shoqërisë dhe shumave të raportuara të aktiveve, detyrimeve, të ardhurave dhe shpenzimeve. Rezultati aktual mund të ndryshojë nga këto vlerësime.

Vlerësimet dhe supozimet e ndërlidhura rishikohen në vazhdimësi. Rishikimet e vlerësimeve kontabël njihen në periudhën në të cilën vlerësimi është rishikuar dhe në ato pasardhëse të ndikuara.

Në veçanti, informacioni mbi fushat e rëndësishme të vlerësimit të pasigurisë dhe gjykimeve kritike në aplikimin e politikave kontabël që kanë ndikimin më të rëndësishëm në shumën e njohur në pasqyrat financiare janë përshkruar në shënimet përkatëse të pasqyrave financiare.

## 3. POLITIKA TË RËNDËSISHME KONTABËL

### 3.1 Standardet e reja dhe të rishikuara efektive për vitim e mbyllur më 31 dhjetor 2015

Standartet e mëposhtme, të cilat janë kryesisht amendime të standarteve ekzistuese dhe interpretime të nxjerra nga Bordi Ndërkombëtar i Standarteve Kontabël janë efektive për periudhën aktuale.

- **Ndryshimet e SNK 19 “Përfitimet e punonjësve”** – Përcaktimi i planeve të përfitimit: Kontributet e Punonjësve (efektive për periudhat që fillojnë nga 1 korrik 2014),
- **Ndryshime në standartet e ndryshme “Përmirësimet e SNRF-ve (cikli 2010-2012)”** – Ndryshime që rezultojnë nga rishikimi vjetor që u është bërë SNRF-ve (SNRF 2, SNRF 3, SNRF 8, SNRF 13, SNK 16, SNK 24 dhe SNK 38) kryesisht me qëllim që të shmangen mospërputhjet dhe të qartësohet formulimi i standartit (ndryshimet duhet të zbatohen për periudhat vjetore që fillojnë nga data 1 korrik 2014),
- **Ndryshime në standartet e ndryshme “Përmirësimet e SNRF-ve (cikli 2011-2013)”** – Ndryshime që rezultojnë nga rishikimi vjetor që u është bërë SNRF-ve (SNRF 1, SNRF 3, SNRF 13 dhe SNK 40), kryesisht me qëllim që të shmangen mospërputhjet dhe të qartësohet formulimi i standartit (ndryshimet duhet të zbatohen për periudhat vjetore që fillojnë nga data 1 korrik 2014).

Adaptimi i këtyre ndryshimeve tek standartet ekzistuese nuk ka çuar në ndryshime për sa i përket politikave kontabël të Shoqërisë.



### 3. POLITIKA TË RËNDËSISHME KONTABËL (VAZHDIM)

#### 3.2 Standarde dhe interpretime të publikuara që nuk janë ende të aplikueshme

Në datën e autorizimit të këtyre pasqyrave financiare, standardet, përmirësimet dhe interpretimet e mëposhtme ishin publikuar por akoma nuk ishin në fuqi.

- SNRF 9 "Instrumentat financiare" (efektiv për periudhat vjetore që fillojnë më apo pas datës 1 janar 2018),
- SNRF 14 "Rregullimi i Llogarive të Shtyra" - (efektive duke filluar 1 Janar 2016 e në vazhdim)
- SNRF 15 "Të ardhura nga Kontratat me Klientët" dhe ndryshime të mëtejshme (efektive duke filluar 1 Janar 2018 e në vazhdim),
- SNRF 16 "Qiratë" (efektive duke filluar 1 Janar 2019 e në vazhdim),
- Ndryshime në SNK 1 "Paraqitja e pasqyrave financiare" - Iniciativat e zbulimit (efektiv për periudhat vjetore që fillojnë më apo pas datës 1 Janar 2016),
- Ndryshimet në SNK 7 "Pasqyra e Fluksit të Parasë" - Nisma Për Paraqitje (efektive për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 Janar 2017),
- Ndryshime në SNK 12 "Tatimet mbi të ardhurat", - Njohja e aktiveve tatimore të shtyra për Humbjet e Perealizuara (efektive për vjetore periudhat që fillojnë më ose pas datës 1 Janar 2017),
- Ndryshime në SNK 16 "Prona, Impiantet dhe Pajisjet" dhe SNK 38 "Aktive jo-materiale" - Sqarim i metodave të pranueshme të zhvleresimit dhe amortizimit (efektiv për periudhat vjetore që fillojnë më apo pas datës 1 Janar 2016),
- Ndryshime në SNK 16 "Prona, Impiantet dhe Pajisjet" dhe SNK 41 "Agrobiznesi" - Agrobiznes: Bimët bartesi (efektiv për periudhat vjetore që fillojnë më apo pas datës 1 Janar 2016),
- Ndryshime në disa standarde "Përmirësimet e SNRF-ve (2012-2014)" që rezultojnë nga projekti i përmirësimit vjetor të SNRF-ve (SNRF 5, SNRF 7, SNRF13, SNK 19, SNK 34) kryesisht me qëllim heqjen e mospërputhjeve dhe sqarimin e fjalëve (ndryshimet duhet të aplikohen për periudhat vjetore që fillojnë më apo pas datës 1 Janar 2016).

Shoqëria ka vendosur të mos i adaptojë këto standarde, rishikime dhe interpretime përpara datave efektive të tyre. Drejtimi parashikon se adoptimi i këtyre standarteve nuk do të ketë impakt material në pasqyrat financiare të Shoqërisë në periudhën fillestare të zbatimit.

#### 3.3 Transaksionet në monedhë të huaj

Transaksionet në monedhë të huaja konvertohen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit në datën e transaksionit. Fitimet dhe humbjet nga kursi i këmbimit që rezultojnë nga kryerja e transaksioneve të tilla dhe nga konvertimi i zërave monetarë në monedhë të huaj me kursin e fundit të vitit janë njohur në fitim dhe humbje.

Zërat jo monetare që maten në bazë të kostos historike në monedhë të huaj (konvertohen duke përdorur kursin e këmbimit në datën e transaksionit), përveç zërave jo-monetarë të matur me vlerën e drejtë të cilët konvertohen me kursin e datës kur është përcaktuar vlera e drejtë.

Kurset zyrtare të këmbimit të Bankës së Shqipërisë në datën e raportimit janë si vijon:

#### 31 dhjetor 2015

Lek / USD	125.79
Lek / EUR	137.28

### 3. POLITIKA TË RËNDËSISHME KONTABËL (VAZHDIM)

#### 3.4 Aktive afatgjata materiale

Aktivët afatgjata materiale mbahen me kosto historike duke zbritur amortizimin e akumuluar dhe ndonjë humbje të akumuluar nga zhvlerësimi, nëse ka. Kosto historike përfshin shpenzime të cilat lidhen drejtpërdrejt me koston e blerjes së aktivitetit. Kostot e mëpasshme përfshihen në vlerën kontabël të aktivitetit afatgjatë material ose njihen si aktiv më vete vetëm nëse është e mundur që Shoqëria të ketë përfitime të ardhshme ekonomike të lidhura me aktivin në fjalë dhe kostoja e tij të mund të matet në mënyrë të besueshme. Të gjithë shpenzimet e tjera të mirëmbajtjeve dhe riparimeve njihen në fitim/humbje në momentin që ato ndodhin.

Amortizimi llogaritet në mënyrë lineare për të shpërndarë koston e aktiveve afatgjata materiale përgjatë jetës së tyre të dobishme. Amortizimi fillon të njihet në muajin pas atij të blerjes. Jetët e dobishme të zbatuara janë si në vijim:

Përshkrimi i kategorisë	Përqindje / vit
Punime në proces	0%
Pajisje zyre	20%
Automjete	20%
Pajisje IT	25%

#### 3.5 Aktive afatgjata jomateriale

Shoqëria njeh aktiv jomaterial afatgjatë nga një marrëveshje shërbimi konçensionare në momentin kur i lind e drejta për përdorimin e infrastrukturës së konçensionit. Aktivët jomateriale afatgjata janë matur fillimisht me kosto e cila është vlera e drejtë e paguar për të marrë shërbimet konçensionare të marrëveshjes konçensionare. Pas njohjes fillestare aktivët jomateriale afatgjata maten me kosto minus amortizimin e akumuluar dhe humbjen e akumuluar nga dëmtimet.

Shoqëria ka aplikuar KNIRF 12 *Marrëveshjet për Shërbimet Konçensionare* të efektshme për periudhën vjetore më apo pas dates 1 janar 2008. Interpretimi është aplikuar për herë të parë në përgatitjen e pasqyrave financiare më dhe për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2011 në përputhje me IAS 8 Politikat Kontabël, ndryshimet në vlerësimet dhe gabimet kontabël të përshkruara në shënimin 22 të pasqyrave financiare. Sipas KNIRF 12 *Marrëveshjet për Shërbimet Konçensionare* aktivët afatgjata jomateriale përfaqësojnë të drejtën e Shoqërisë për të përfituar shërbime konçensionare në këmbim të shpërblimeve jo monetare të kaluara dhënësit të grantit.

Sipas marrëveshjes ndërmjet Shoqërisë dhe dhënësit të grantit aktivët afatgjata jomateriale përfshijnë elementët që përfshijnë shpërblime jomonetare në këmbim të shërbimeve konçensionare të marra:

##### - Shpenzimet vijuese

Shpenzimet vijuese kapitalizohen vetëm kur ato rrisin përfitimet e ardhshme ekonomike të përfshirë specifikisht në aktivin të cilit i përket. Shpenzimi tjetër është i njohur në pasqyrat e të ardhurave gjithëpërfshirëse (në fitim ose humbje) kur ka ndodhur.

##### - Amortizimi

Jeta e dobishme e vlerës së mbetur të aktivitetit afatgjatë jomaterial që i përket marrëveshjes së shërbimit konçensionar është periudha që kur vendoset në dispozicion deri në fund të periudhës së konçensionit, 10 vjet.

Jeta e dobishme e vlerës së mbetur të aktivitetit afatgjatë jomaterial që nuk i përket marrëveshjes së shërbimit konçensionar është si më poshtë :

Përshkrimi i kategorisë	Përqindje / vit
Programe informatike	25%

### 3. POLITIKA TË RËNDËSISHME KONTABËL (VAZHDIM)

#### 3.6 Zhvlerësimi i aktiveve jo financiare

Vlerat kontabël e aktiveve jo-financiare të Shoqërisë, përveç inventarit dhe tatimit të shtyrë, janë rishikuar në datën e raportimit për të përcaktuar në qoftë se ka ndonjë tregues zhvlerësimi. Në qoftë se ndonjë tregues i tillë ekziston, atëherë llogaritet vlera e rikuperueshme e aktivitetit. Humbja nga zhvlerësimi njihet në qoftë se vlera e mbartur e aktivitetit e kalon vlerën e rikuperueshme të tij. Humbjet nga zhvlerësimi janë njohur në të ardhura ose shpenzime.

Humbja nga zhvlerësimi njihet nëse vlera kontabël e një aktivi ose njësisë gjeneruese të parasë së tij, tejkalon vlerën e tij të rikuperueshme. Njësia gjeneruese e parasë është grupi më i vogël i identifikueshëm aktivesh që gjeneron rrjedhje parash që janë të pavarura nga aktivet dhe grupet e tjera.

Humbjet nga zhvlerësimi njihen në të ardhura dhe shpenzime. Shuma e rikuperueshme e një aktivi ose një njësie gjeneruese të parasë, është vlera më e lartë midis vlerës në përdorim dhe vlerës së drejtë minus kostot e shitjes. Në vlerësimin e vlerës në përdorim, rrjedhja e pritshme e ardhshme e parasë është skontuar në vlerën aktuale duke përdorur normën e skontimit para taksës që reflekton vlerën aktuale të parasë në treg dhe rreziqet specifike të aktivitetit.

Përsa i përket aktiveve të tjera, një humbje nga zhvlerësimi rimerret nëse ka tregues që humbja nga rivlerësimi nuk ekziston më dhe që ka pasur ndryshime në vlerësimet e përdorura për të përcaktuar vlerën e rikuperueshme. Një humbje nga zhvlerësimi, rimerret vetëm nëse vlera kontabël e aktivitetit nuk e kalon vlerën që do të ishte përcaktuar, neto me zhvlerësimin ose amortizimin, nëse zhvlerësimi nuk do të ishte njohur.

#### 3.7 Instrumentat Financiare

Shoqëria mban vetëm instrumente financiare jo-derivative që përbëhen nga llogari të arkëtueshme dhe të tjera, mjete monetare dhe ekuivalentet e tyre, huatë dhe detyrime tregtare dhe të tjera. Instrumentat financiarë jo-derivative njihen fillimisht me vlerën e drejtë plus, për instrumentat jo në vlerën e drejtë përmes fitimit ose humbjes, duke i shtuar çdo kosto që lidhet drejtpërdrejtë me transaksionin. Pas njohjes fillestare, instrumentat financiarë jo-derivative maten si më poshtë.

Një aktive financiar njihet nëse Shoqëria bëhet pjesë në kushtet kontraktuale të aktivitetit. Shoqëria çregjistron një aktiv financiar kur të drejtat kontraktuale mbi flukset e parasë nga aktivet financiare skadojnë ose në qoftë se ajo transferon të drejtat për të arkëtuar flukset e parasë kontraktuale të aktivitetit financiar në një transaksion në të cilin pothuajse të gjithë rreziqet dhe përfitimet e zotërimit të aktivitetit financiar transferohen. Blerjet dhe shitjet e aktiveve financiare regjistrohen në datën e tregtimit, data në të cilën Shoqëria angazhohet për blerjen ose shitjen e aktivitetit. Detyrimet financiare çregjistrohen nëse detyrimet e Shoqërisë të specifikuar në kontratë skadojnë, janë hequr ose anuluar.

##### *Mjetet monetare dhe ekuivalentet e tyre*

Mjetet monetare dhe ekuivalentet e tyre përbëhen nga para në arkë, llogaritë rrjedhëse bankare dhe investime afatshkurtra me likuiditet të lartë të cilat kanë maturitet tre muaj ose më pak, të cilat nuk janë subjekt i rreziqeve të rëndësishme të ndryshimit të vlerës së drejtë, dhe përdoren nga Shoqëria për manaxhimin e angazhimeve afatshkurtra. Para dhe ekuivalentet e saj mbahen me koston e amortizuar në pasqyrën e pozicionit financiar.

##### *Llogari të arkëtueshme dhe të tjera*

Llogaritë e arkëtueshme fillimisht njihen me vlerë të drejtë dhe në vazhdimësi maten me koston e amortizuar minus humbjet nga zhvlerësimi.

Provizioni për zhvlerësimin e llogarive të arkëtueshme krijohet kur ka tregues objektive që Shoqëria nuk do të jetë në gjendje të mbledhë të gjitha shumat sipas kushteve origjinale të llogarive të arkëtueshme.

Vështirësitë e konsiderueshme financiare të debitorit, mundësia që debitori të falimentojë ose të ndodhë një riorganizim financiar dhe mospagesat konsiderohen indikatorë që llogaritë e arkëtueshme janë zhvlerësuar.

### 3. POLITIKA TË RËNDËSISHME KONTABËL (VAZHDIM)

#### 3.7 Instrumentat Financiare (vazhdim)

Provizijoni është diferenca midis vlerës kontabël të aktivitetit dhe vlerës aktuale të flukseve monetare të ardhshme, të skontuara me normën e interesit efektiv. Aktivitetet me maturitet afatshkurtër nuk diskontohen. Vlera kontabël e aktivitetit zvogëlohet përmes përdorimit të një llogarie provizijoni dhe shumata e humbjes njihet në fitim ose humbje. Kur një llogari e arkëtueshme është e pambledhshme, vlera në pasqyrën e pozicionit financiar mbyllet kundrejt provizijonit për këtë llogari. Nëse shumata rikuperohen më vonë, ato regjistrohen në fitim ose humbje.

##### *Huatë*

Pas njohjes fillestare, huatë që mbartin interes regjistrohen me kosto të amortizuara me çdo diferencë midis koston dhe vlerës së rimarrjes dhe njihet në fitim ose humbje gjatë periudhës së huamarrjes mbi bazën e interesit efektiv.

##### *Llogaritë e pagueshme dhe të tjera*

Llogaritë e pagueshme fillimisht njihen me vlerën e drejtë dhe në vazhdimësi maten me koston e amortizuar.

##### *Njohja e zhvlerësimit të aktiveve financiare*

Një aktiv financiar konsiderohet i zhvlerësuar nëse ka tregues objektiv që tregon se një ose disa ngjarje kanë pasur një ndikim negativ në flukset e ardhshme monetare të vlerësuara të aktivitetit financiar.

Një zhvlerësim në vlerë në lidhje me një aktiv financiar të matur me kosto të amortizuara është llogaritur si diferencë mes vlerës kontabël dhe vlerës aktuale të flukseve të ardhshme të parasë të vlerësuara duke i skontuar me normën origjinale efektive të interesit të aktivitetit.

Aktivitetet financiare individualisht të rëndësishme testohen për zhvlerësim në bazë individuale. Aktivitetet e mbetura financiare vlerësohen në mënyrë kolektive në grupe që ndajnë karakteristika të ngjashme të rrezikut të kredisë. Të gjitha humbjet nga zhvlerësimi njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve. Një humbje nga rënia në vlerë anulohet nëse kthimi mund të lidhet objektivisht me një ngjarje që ka ndodhur pasi zhvlerësimi është njohur. Rimarrja njihet në fitim dhe humbje.

#### 3.8 Njohja e të ardhurave

Të ardhurat përfshijnë të ardhurat nga kryerja e shërbimeve. Të ardhurat maten me vlerën e drejtë të shumës së marrë ose që është për t'u marrë nga Shoqëria për shërbimet e kryera, duke përjashtuar taksat e shitjes dhe zbritjet.

Shoqëria zbaton kriteret e njohjes së të ardhurave të paraqitura si më poshtë për secilën pjesë të identifikueshme të transaksionit të shitjes, në mënyrë që të reflektojë përmbajtjen e transaksionit.

Shpërblimi i marrë nga këto transaksione, është shpërndarë veçmas për secilin komponent duke marrë parasysh vlerën relative të drejtë për secilin komponent.

##### *Kryerja e shërbimeve*

E ardhura nga kryerja e shërbimeve njihet kur shumata e të ardhurave mund të matet me besueshmëri, mbledhja është e mundshme. Kostot që kanë ndodhur ose që do të ndodhin lidhur me transaksionin mund të maten në mënyrë të besueshme dhe kur kriteret për secilën nga aktivitetet e Shoqërisë janë plotësuar.

Këto kritere specifike të njohjes së të ardhurave nga aktiviteti janë bazuar në shërbimin e ofruar konsumatorit dhe kushteve të kontratës. Bazuar në Konstatën e konçesionit midis 3P Life Logistic sh.p.k. dhe Ministrisë së Shëndetësisë, Shoqëria është e autorizuar të ofrojë shërbime të kontrollit mjekësor bazë për grupmoshat 40-65 vjeç bazuar kushteve të kontratës së konçesionit.

### **3. POLITIKA TË RËNDËSISHME KONTABËL (VAZHDIM)**

#### **3.9 Përfitimet e detyrueshme të punonjësve**

##### *Kontributet e sigurimeve shoqërore*

Gjatë ecurisë normale të biznesit, Shoqëria bën pagesa në emër të saj dhe të punonjësve për kontributet e detyrueshme të pagave sipas legjislacionit vendor. Këto kosto të kryera në emër të Shoqërisë, janë të paraqitura në pasqyrën përmbledhëse të të ardhurave në momentin e ndodhjes.

#### **3.10 Tatimi mbi fitimin aktual dhe i shtyrë**

Tatimi mbi fitimin përbëhet nga tatimi i periudhës dhe tatimi i shtyrë. Tatimi mbi fitimin njihet në të ardhura ose shpenzime përveç rasteve kur lidhen me zëra të njohur direkt në kapital apo në të ardhura të tjera gjithpërfshirëse.

Tatimi i periudhës është tatimi i pritshëm për tu paguar apo arkëtuar mbi fitimin e tatueshëm apo humbjen për vitin, duke përdorur normat e tatimeve që kanë hyrë ose do të hyjnë në fuqi deri në datën e raportimit dhe çdo sistemim mbi tatimin e pagueshëm të lidhur me vitet e mëparshme. Norma e tatimit mbi fitimin për vitin 2015 është 15% e të ardhurës së tatueshme.

Tatimi i shtyrë njihet duke paraqitur diferencat e përkohshme midis vlerave kontabël të aktiveve dhe detyrimeve për qëllime raportimi financiar dhe vlerave të përdorura për qëllime tatimore. Tatimi i shtyrë matet me normat tatimore që priten të aplikohen për diferencat e përkohshme kur ato të kthehen, duke përdorur normat e tatimeve që kanë hyrë ose do të hyjnë në fuqi deri në datën e raportimit.

Një aktiv për tatimin e shtyrë njihet nëse është e mundshme që të ardhura të tatueshme të ardhshme do të realizohen kundrejt të cilave mund të përdoren diferencat e përkohshme. Aktivet e tatimit të shtyrë rishikohen në çdo datë raportimi dhe zvogëlohen deri sa nuk janë më të mundshme të realizohen përfitime tatimore të lidhura me të. Në bazë të pasigurive të lidhura me realizimin e aktivitetit tatimor të shtyrë (të cilat vijnë nga diferencat e përkohshme të aktiveve për të cilat baza tatimore është më e madhe se vlera kontabël) të lidhura edhe me kohëzgjatjen e kontratës së konçesionit, Shoqëria nuk ka njohur asnjë aktiv tatimor të shtyrë në pasqyrat financiare më 31 dhjetor 2015.

#### **3.11 Provigjionet**

Provigjionet njihen kur si rezultat i ngjarjeve në të kaluarën, Shoqërisë i lindin detyrime (ligjore ose konstruktive) të cilat mund të parashikohen me besueshmëri dhe është e mundur që të ndodhë një dalje e përfitimeve ekonomike për shlyerjen e detyrimit.

Nëse efekti është material, provigjionet janë përcaktuar duke ju zbritur vlerën e pritshme të flukseve të parasë të skontuara me një normë para tatimit që reflekton vlerësimet aktuale të tregut për vlerën në kohë të parasë dhe risqet specifike të detyrimeve. Provigjionet rishikohen në çdo datë raportimi dhe nëse nuk ka mundësi për nevojën e një rrjedhë burimesh që përfshin përfitime ekonomike për shlyerjen e detyrimit, provigjionet rimerren. Provigjionet përdoren vetëm për qëllimin për të cilin janë njohur fillimisht. Nuk njihet provigjion për humbjet e ardhshme operative. Aktivet dhe detyrimet e kushtëzuara nuk njihen.

#### **3.12 Angazhime dhe detyrime të ardhshme**

Detyrimet e kushtëzuara nuk njihen në pasqyrat financiare. Për një pasiv të kushtëzuar jepet informacion shpjegues vetëm kur mundësia e një daljeje burimesh që përfshin përfitime ekonomike nuk ekziston më. Aktivet e kushtëzuara nuk njihen në pasqyrat financiare por jepet informacion shpjegues kur realizimi i të ardhurave është i mundur. Shuma e humbjes së kushtëzuar njihet si provigjion nëse është e mundur që ngjarje të ardhshme do ta konfirmojnë atë, një detyrim lind në datën e pozicionit financiar dhe mund të bëhet një vlerësim i arsyeshëm i humbjes.

## 4. AKTIVET AFATGJATA MATERIALE

Aktivet afatgjata materiale më 31 dhjetor 2015 janë të përbëra si më poshtë:

Kosto	Pajisje zyre	Pajisje IT	Automjete	Punime në proces	Totali
<b>Gjendja më 31 dhjetor 2014 (të pa audituara)</b>					
Shtesa	11,576,963	1,934,963	103,992,148	48,719,225	166,223,299
Pakësime	-	-	-	-	-
<b>Gjendja më 31 dhjetor 2015</b>	<b>11,576,963</b>	<b>1,934,963</b>	<b>103,992,148</b>	<b>48,719,225</b>	<b>166,223,299</b>
<b>Amortizim i akumuluar</b>					
<b>Gjendja më 31 dhjetor 2014 (të pa audituara)</b>					
Amortizimi i vitit	(1,717,785)	(325,448)	-	-	(2,043,233)
Pakësime	-	-	-	-	-
<b>Gjendja më 31 dhjetor 2015</b>	<b>(1,717,785)</b>	<b>(325,448)</b>	<b>-</b>	<b>-</b>	<b>(2,043,233)</b>
<b>Vlera kontabël neto</b>					
<b>Gjendja më 31 dhjetor 2015</b>	<b>9,859,179</b>	<b>1,609,515</b>	<b>103,992,148</b>	<b>48,719,225</b>	<b>164,180,067</b>

**5. AKTIVET AFATGJATA JOMATERIALE KONTRATA E KONÇESIONIT**

Aktivet afatgjata materiale më 31 dhjetor 2015 janë të përbëra si më poshtë:

	Programe informatike	Riinvestim	Konçesion	Totali
<b>Kosto</b>				
<b>Gjendja më 31 dhjetor 2014 (të pa audituara)</b>	-	-	-	-
Shtesa	298,550	104,115,756	204,620,059	309,034,365
Pakësime	-	-	(958,838)	(958,838)
<b>Gjendja më 31 dhjetor 2015</b>	<b>298,550</b>	<b>104,115,756</b>	<b>203,661,221</b>	<b>308,075,527</b>
<b>Amortizim i akumuluar</b>				
<b>Gjendja më 31 dhjetor 2014 (të pa audituara)</b>	-	-	-	-
Amortizimi i vitit	(22,709)	(10,411,576)	(13,265,180)	(23,699,465)
<b>Gjendja më 31 dhjetor 2015</b>	<b>(22,709)</b>	<b>(10,411,576)</b>	<b>(13,265,180)</b>	<b>(23,699,465)</b>
<b>Vlera kontabël neto</b>				
<b>Gjendja më 31 dhjetor 2015</b>	<b>275,841</b>	<b>93,704,180</b>	<b>190,396,041</b>	<b>284,376,062</b>

**6. MJETET MONETARE DHE EKVIVALENTET E TYRE**

Mjetet monetare dhe ekuivalentet e tyre më 31 dhjetor 2015 janë si më poshtë:

	Më 31 Dhjetor 2015	Më 31 Dhjetor 2014 (të pa audituar)
Llogari rrjedhëse në Lek	12,580,143	30,000,000
Llogaritë rrjedhëse në Euro	56,656	-
Arka në Lek	20	-
<b>Totali</b>	<b>12,636,819</b>	<b>30,000,000</b>

Kompania ka llogari rrjedhëse në Euro dhe Lek tek banka Intesa SanPaolo dhe Raiffeisen. Më 31 dhjetor 2014 balanca tregon pagesën e Kapitalit Aksionar.

**7. LLOGARITË E ARKËTUESHME DHE TË TJERA**

Llogaritë e arkëtueshme dhe të tjera më 31 Dhjetor 2015 janë të detajuara si më poshtë:

	Më 31 Dhjetor 2015	Më 31 Dhjetor 2014 (të pa audituara)
<b>Llogaritë e arkëtueshme</b>		
Llogaritë e arkëtueshme nga Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor (FSDKSH)	73,006,891	-
<b>Totali i llogarive të arkëtueshme</b>	<b>73,006,891</b>	<b>-</b>
<b>Llogari të tjera të arkëtueshme</b>		
TVSH e arkëtueshme	41,930,151	-
<b>Totali i llogari të tjera të arkëtueshme</b>	<b>41,930,151</b>	<b>-</b>
<b>Totali</b>	<b>114,937,042</b>	<b>-</b>

Llogaritë e arkëtueshme përbëhen nga kontrollat mjekësore të kryera nga Kompania që duhet të rimburohen nga Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor.

**8. KAPITALI AKSIONAR**

Më 31 dhjetor 2015 kapitali aksionar ka qënë 30,000,000 Lek dhe përfshin 24,000,000 aksione me vlerë nominale Lek 1 për aksion, të zotëruara tërësisht nga Marketing & Distribution sh.p.k. dhe 6,000,000 aksione të zotëruara nga Trimed sh.p.k.

**9. LLOGARITË E PAGUESHME**

Llogaritë e pagueshme më 31 Dhjetor 2015 janë të detajuara si më poshtë:

	Më 31 Dhjetor 2015	Më 31 Dhjetor 2014 (të pa audituara)
Të pagueshme ndaj palëve të lidhura	195,184,309	-
Të pagueshme ndaj kompanive	163,960,694	-
Të pagueshme ndaj individëve	20,167,191	-
<b>Totali</b>	<b>379,312,194</b>	<b>-</b>

Të pagueshmet tregtare ndaj palëve të lidhura përbëhen nga vlerat prej Lek 192,041,599 për Marketing & Distribution sh.p.k dhe Lek 3,142,709 për Trimed sh.p.k.

Nga të pagueshmet ndaj kompanive, 50% e shumës totale (Lek 88,479,793) përfshin shërbimet e mirëmbajtjes nga Interlogistic sh.p.k bazuar në kontratë midis dy palëve.

Nga ana tjetër, të pagueshmet ndaj individëve lidhen me shërbime nga specialistë të kryera në fillim të biznesit në mënyrë që të krijojë procesin e biznesit dhe kontrollat e brendshme në laboratorë.



**10. DETYRIME TË TJERA**

Detyrime të tjera më 31 Dhjetor 2015 janë të detajuara si më poshtë:

	Më 31 dhjetor 2015	Më 31 dhjetor 2014 (të pa audituara)
Pagat e punonjësve	4,777,090	-
Parapagimet	210,482	-
Të pagueshme të tjera	904,583	-
<b>Totali</b>	<b>5,892,155</b>	<b>-</b>

**11. GRANT NGA PEGASUS**

Grant nga Pegasus më 31 dhjetor 2015 është si vijon:

	Më 31 dhjetor 2015	Më 31 dhjetor 2014 (të pa audituara)
Pegasus sh.p.k.	32,574,703	-
<b>Totali</b>	<b>32,574,703</b>	<b>-</b>

Kompania ka nënshkruar një kontratë me Pegasus sh.p.k. për dhurimin e aktiveve të laboratorit dhe programit informatik për përdorimin e këtyre pajisjeve të nevojshme për të kryer analizat e check-up. Pegasus ua ka dhënë në përdorim këto pajisje pasi Kompania blen reagentët tek Pegasus me vlerë të konsiderueshme.

**12. VLERA E RIINVESTIMIT**

Detyrimi aktual për të riinvestuar investimin total prej Lekë 129,999,890 në 4 vitet e fundit, bazuar në marrëveshjen e konçesionit, është njohur si një detyrim afatgjatë duke qenë se daljet e burimeve që përfshijnë përfitime ekonomike do të shlyejnë detyrimin në tre vitet e fundit të marrëveshjes.

Kompania ka vlerësuar vlerën aktuale të detyrimit për shumën e riinvestimit 104,115,756 Lek më 31 dhjetor 2015.

**13. TË ARDHURA**

Të ardhurat për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2015 janë të përbëra si më poshtë:

	Për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2015	Për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2014 (të pa audituara)
Të ardhurat nga Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor	554,036,242	-
<b>Totali</b>	<b>554,036,242</b>	<b>-</b>

Të ardhurat përfshijnë vetëm cmimin e kontrolleve mjekësore të kryera nga Kompania dhe të paguara nga Garantori.

**Shënim**

Të ardhurat sipas Formularit të deklarimit të pagesave dhe sipas pasqyrave financiare përbëhet si më poshtë:

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015
Të ardhurat sipas formularit të deklarimit të pagesave (FDP)	576,420,310
Të ardhurat sipas pasqyrave + të ardhura të tjera (pjesërisht)	(681,216,233)
<b>Diferenca</b>	<b>(104,795,923)</b>

Diferenca në vlerë Lek 104,795,923 është deklaruar si e ardhur nëpërmjet deklaratave FDP dhe si kosto e mallrave të shitura. Kjo vlerë përfaqëson produkte të shpërndara në laboratorë në bazë të kërkesave dhe nevojave të tyre. Për pasqyrat financiare të përgatitura në përputhje me SNRF, shumat prej 104,795,923 Lek, e deklaruar si e ardhur është netuar me të njëjtën sasi, klasifikuar si kosto e mallrave të shitura.

**14. TË ARDHURA TË TJERA**

Të ardhurat e tjera për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2015 janë të përbëra si më poshtë:

	Për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2015	Për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2014 (të pa audituara)
Të ardhura të tjera	17,792,347	-
Të ardhura Granti- asete nga Pegasus	3,123,601	-
<b>Totali</b>	<b>20,983,888</b>	<b>-</b>

**15. SHPENZIME PËR KONTRATËN E KONÇESIONIT**

Shpenzimet për kontratën e konçesionit për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2015 janë të përbëra si më poshtë:

	<b>Për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2015</b>	<b>Për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2014 (të pa audituara)</b>
Shpenzime sipas kontratës me M&D	178,216,182	-
Shpenzimet e reagentëve	54,832,941	-
<b>Totali</b>	<b>233,049,123</b>	<b>-</b>

Shpenzimet e reagentëve përfaqësojnë shpenzimet e bëra për të blerë reagentë për të kryer kontrollet e check-up Këto janë shpenzimet e bëra me qëllim të kryerjes së shërbimeve sipas marrëveshjes së konçesionit. Shpenzimet sipas kontratës me M & D paraqet marrëveshjen midis Kompanisë dhe palës së lidhur Marketing & Distribution Sh.p.k. Në bazë të marrëveshjes së parë, M&D i ka dhënë Kompanisë një listë asetesh me qera operationale. Marrëveshja e dytë i referohet shpenzimeve të kryera me qëllim të ruajtjes dhe mbarëvajtjes së pajisjeve laboratorike si dhe programe informatike, të nevojshme për të kryer kontrollet e check up.

**16. SHPENZIME PERSONELI**

Shpenzimet e personelit për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2015 janë të përbëra si më poshtë:

	<b>Për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2015</b>	<b>Për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2014 (të pa audituara)</b>
Pagat bruto	47,060,574	-
Sigurimet shoqërore	7,530,621	-
<b>Totali</b>	<b>54,591,195</b>	<b>-</b>

**17. SHPENZIME TË TJERA OPERATIVE**

Shpenzime të tjera operative për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015 janë të detajuara si më poshtë:

	Për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2015	Për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2014 (të pa audituara)
Shpenzime administrative	52,595,430	-
Shpenzime laborator	51,339,851	-
Shpenzime qeraje	26,561,351	-
Shpenzime operacionale	25,061,146	-
Shpenzime mirëmbajtjeje	16,723,727	-
Shpenzime karburanti	14,340,648	-
Shpenzime transporti dhe dieta	6,567,500	-
Shpenzime per disinfektme dhe heqje të mbeturinave	4,751,754	-
Shpenzime ligjore	1,672,964	-
Shpenzime marketingu dhe promovimi	1,165,484	-
Komisione bankare	12,700	-
Shpenzime të tjera	4,718,514	-
<b>Totali</b>	<b>205,511,069</b>	<b>-</b>

**18. TË ARDHURA FINANCIARE**

Të ardhurat financiare detajohen si më poshtë:

	Për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2015	Për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2014 (të pa audituara)
Të ardhura nga kursi i këmbimit	17,687	-
<b>Totali</b>	<b>17,687</b>	<b>-</b>

**19. TATIMI MBI FITIMIN**

	Për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2015	Për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2014 (të pa audituara)
Fitimi para tatimit	56,324,936	-
Shpenzimet e pazbritshme	11,681,118	-
Fitimi tatueshëm	67,824,851	-
<b>Shpenzim tatim fitimi (15%)</b>	<b>10,173,728</b>	<b>-</b>

**19. TATIMI MBI FITIMIN (VAZHDIM)**

Lista e detajuar e shpenzimeve të pazbritshme fiskalisht:

<b>Shpenzimet e pazbritshme për efekt fiskal 2015</b>	<b>Vlera në Lek</b>
a- Amortizimi i Riinvestimit	10,411,675
b- Gjoha	55,755
c- Shpenzime të tjera të pazbritshme	2,203
d- Shpenzime pa faturë	1,196,863
e- Shpenzime përfaqësimi	4,300
f- Shpenzime të tjera	10,322
<b>Totali i shpenzimeve të pazbritshme</b>	<b>11,681,118</b>

Kompania është subjekt i taksës mbi të ardhurat në Shqipëri, norma e tatimit është 15% për 2015. Formularët e deklarimit të taksave dorëzohen çdo vit. Ligjet shqiptare dhe rregullat e taksimit janë subjekt i interpretimit nga autoritetet e taksave.

**20. ANGAZHIME DHE PASIGURI***Kërkesa ligjore*

Gjatë aktivitetit normal të saj, Kompania mund të jetë subjekt i kërkesave të ndryshme ligjore. Më 31 dhjetor 2015, Kompania nuk ka patur pretendime ligjore, të cilat konsiderohen normale gjatë rrjedhës së aktivitetit të saj.

*Angazhimet*

Nuk ka zotime të rëndësishme kapitale të kontraktuara në datën e pasqyrës së pozicionit financiar, që nuk janë njohur tashmë në pasqyrat financiare.

**21. TRANKSAKSIONET ME PALËT E LIDHURA**

	<b>Llogari të arkëtueshme</b>	<b>Llogari të pagueshme</b>	<b>Të ardhura</b>	<b>Kostot</b>
<b>Më dhe për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015</b>				
Marketing & Distribution Sh.p.k	193,919,455	969,791	18,354,806	554,752,696
Trimed	-	3,142,709	67,061,875	3,136,873
<b>Totali</b>	<b>193,919,455</b>	<b>4,112,500</b>	<b>85,416,681</b>	<b>557,889,569</b>

**22. NGJARJE PAS DATËS SË RAPORTIMIT**

Nuk ka ngjarje të tjera të rëndësishme pas datës së raportimit, të cilat mund të kërkojnë rregullim ose prezantim në pasqyrat financiare.

**23. ADMINISTRIMI I RREZIKUT FINANCIAR****23.1 Faktorët e rrezikut financiar**

Aktiviteti i Shoqërisë e ekspozon atë ndaj disa rreziqesh financiare, duke përfshirë rrezikun e kredisë, rrezikun nga kurset e këmbimit dhe rrezikun e normave të interesit. Administrimi i rrezikut të Shoqërisë përqëndrohet në paparashikueshmërinë e tregut dhe kërkon të minimizojë efektet e mundshme negative mbi performancën e biznesit të Shoqërisë.

Administrimi i rrezikut bëhet nga drejtimi duke u bazuar në disa politika e procedura të shkruara dhe të aprovuara, të cilat mbulojnë të gjithë administrimin e rrezikut dhe pjesë specifike si rreziku i kursit të këmbimit, rreziku i normave të interesi, rreziku i kredisë, rreziku i likuiditetit.

**23.2 Rreziku i tregut***Rreziku nga kurset e këmbimit*

Shoqëria është e ekspozuar ndaj rrezikut të kursit të këmbimit që vjen prej ekspozimit ndaj monedhave të huaja, kryesisht ndaj monedhës së Euros. Shoqëria nuk përdor ndonjë instrument për t'u mbrojtur nga rreziku i kursit të këmbimit. Drejtimi i Shoqërisë është përgjegjës për të mbajtur një pozicion të përshtatshëm neto në çdo monedhë dhe në total si dhe të monitorojë operacionet me bazë ditore.

Vlera e mbartur e aktiveve dhe detyrimeve të Shoqërisë në monedhë të huaj është si më poshtë:

		<b>Më 31 dhjetor 2015</b>
		<b>Në LEK</b>
<b>Assets</b>		
Mjete monetare dhe ekuivalentet e tyre	EURO	56,656
<b>Totali</b>		<b>56,656</b>
<b>Liabilities</b>		
Llogaritë e pagueshme	EURO	310,253
Parapagimet	EURO	190,863
<b>Totali</b>		<b>501,116</b>

*Analiza e ndjeshmërisë ndaj rrezikut të kursit të këmbimit*

<b>31 dhjetor 2015</b>	<b>Vlera e ekspozimit, neto</b>	<b>Fitim ose humbje</b>	
		<b>+10%</b>	<b>-10%</b>
EURO	(444,460)	(44,446)	44,446

Analiza e ndjeshmërisë përfshin vetëm mjetet monetare të shprehura në monedhë të huaj në fund të vitit dhe një korrigjim i vlerave të tyre është bërë për shkak të një ndryshimi me 10% të kurseve të këmbimit. Vlera pozitive/negative tregon rritje/ulje në fitim ose elemente të tjerë të kapitalit, gjë që ndodh kur monedha LEK dobësohet/forcohet në krahasim me monedhat e tjera të huaja me +/- 10%.

**23. ADMINISTRIMI I RREZIKUT FINANCIAR (VAZHDIM)****23.3 Rreziku i likuiditetit**

Shoqëria i drejton nevojat e saj për likuiditet duke monitoruar me kujdes pagesat e huave të skeduluara dhe duke parashikuar hyrjet dhe daljet e parave bazuar në rrjedhën e përditshme të biznesit. Nevojat për likuiditet monitorohen në grupe të ndryshme kohore. Nevojat neto për mjete monetare në arkë krahasohen me mjetet e disponueshme të huamarrjes në mënyrë që të përcaktohet çdo humbje. Kjo analizë tregon nëse mjetet e disponueshme të huamarrjes janë të mjaftueshme për periudhën në shqyrtim. Shoqëria mban para në arkë dhe bankë për të përmbushur nevojat e saj për likuiditet për një periudhë minimale prej 30 ditësh.

Më 31 dhjetor 2015, detyrimet financiare të Shoqërisë kanë maturime kontraktuale si më poshtë:

Më 31 dhjetor 2015	Afatshkurtra 1 deri në 12 muaj	1 deri në 5 vjet	Afatgjata Më shumë se 5 vjet
Llogari të pagueshme	379,312,194	-	-
Detyrime të tjera	5,892,155	-	-
<b>Totali</b>	<b>385,204,349</b>	-	-

Shumat e mësipërme reflektojnë rrjedhjet kontraktuale të mjeteve monetare, të cilat mund të ndryshojnë nga vlerat kontabël të detyrimeve në datën e raportimit.

**23.4. Vlerësimi i vlerë së drejtë**

Vlera e drejtë përfaqëson çmimin që do të merret për të shitur një aktiv ose çmimin që do të paguhet për të transferuar një detyrim në një transaksion normal ndërmjet pjesëmarrësve në treg në datën e matjes.

Deloitte refers to one or more of Deloitte Touche Tohmatsu Limited, a UK private company limited by guarantee and its network of member firms, each of which is a legally separate and independent entity. Please see [www.deloitte.com/al/about](http://www.deloitte.com/al/about) for a detailed description of the legal structure of Deloitte Touche Tohmatsu Limited and its member firms.

Deloitte provides audit, tax, consulting, and transaction advisory services to public and private clients spanning multiple industries. With a globally connected network of member firms in more than 150 countries, Deloitte brings world-class capabilities and high-quality service to clients, delivering the insights they need to address their most complex business challenges. Deloitte's approximately 210,000 professionals are committed to becoming the standard of excellence.

###

Deloitte i referohet një ose më shumë firmave të Deloitte Touche Tohmatsu Limited, një kompani private e limituar nga garancitë, secila prej tyre është entitet ligjor i ndarë dhe i pavarur. Ju lutemi shikoni [www.deloitte.com/al/about](http://www.deloitte.com/al/about) për një përshkrim më të hollësishëm të strukturës ligjore të Touche Tohmatsu Limited dhe firmave të saj anëtare.

Deloitte ofron shërbime në auditim, taksë, konsulencë dhe shërbime të konsulencës financiare për klientë publikë dhe privatë në të gjitha industritë që ato operojnë. Me një rrjet global firmash anëtare në më shumë se 150 vende, Deloitte sjell ekspertizë me nivel ndërkombëtar dhe shërbime me cilësi të lartë për klientët e saj, duke i dhënë bizneseve njohuritë që i nevojiten për adresuar sfidat më komplekse që ata hasin. Pothuajse 210 000 profesionistë angazhohen që Deloitte të jetë etalon i përsosmërisë.

[www.deloitte.com/al](http://www.deloitte.com/al)

© 2016 Deloitte Audit Albania Sh.P.K